

DT 21/12/2021  
N 307/1 PRO

**Drejtuar:** Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar

**Lenda:** Dorezim i Raportit te Audituesit te pavarur per Pasqyrat Financiare te vitit ushtrimor te mbyllur me 31.12.2019.

**I nderuar Z.Ylli,**

Ne zbatim te kontrates se sherbimit lidhur me 26.11.2021 ndermjet meje si Auditues Ligjor dhe Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar per auditimin e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2019, bashkelidhur do te gjeni raportin e auditimit dhe letren per drejtimin e KOKSH.

Referuar kontrates, fatura do te gjenerohet ne sistemin on-line te faturimit.

**Me respekt,**

**Auditues Ligjor**

**Tirane me 20.12.2021**

**Ludmilla Paluka**



---

**RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR**

**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MBYLLURA MË 31 DHJETOR 2019**

**TE OJF - KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR**

---

**Përmbajtja:**

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR ..... 3 fletë

RAPORTI I AUDITUESIT PER DREJTIMIN ..... 4 fletë

**PASQYRAT FINANCIARE TË MBYLLURA MË 31 DHJETOR 2020**

I. Pasqyra e pozicionit financiar ..... 1 fletë

II. Pasqyra e Performancës (aktiviteteve) ..... 1 fletë

III. Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (metoda direkte) ..... 1 fletë

V. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare ..... \_\_ fletë



## **RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR**

**Drejtuar:** Asamblese se Pergjithshme te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar

### **Opinion i kualifikuar**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar-KOKSH**, Organizate jo fitimprurese, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e aktiviteteve, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, *me përjashtim të efekteve të çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin e dhene në raportin tonë*, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pasqyrën e pozicionin financiar të KOKSH, pasqyrën e aktiviteteve dhe flukset e parasë me 31 Dhjetor 2019 në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit per OJF-të .

### **Baza për Opinionin e kualifikuar**

Gjate misionit te auditimit ne konstatuam dhe vleresuam çështjen si vijon:  
Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar ne hartimin e pasqyrave financiare eshte mbështetur ne Standartin Kombetar te Kontabilitetit per OJF-te por ka pasqyruar nje pjese te transaksioneve sipas parimit mbi baza monetare, sipas arketimeve dhe pagesave te kryera.

*Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të).* Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga KOKSH në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### **Çështjet Kryesore të Auditimit**

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim një opinion të veçantë.





## Çeshtje te tjera

Pasqyrat financiare te KOKSH per vitin 2018 jane audituar nga nje tjeter auditues, i cili ka dhene opinion me ceshtje ne vemendje te drejtimet.

## **Përgjegjësitë e Administratorit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi (Komiteti Ekzekutiv dhe Stafi) është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të per OJF-te, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare me qëllim që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.



Auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatmërisë së politikave kontabël të përdorura, të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin për paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne kemi pergatitur nje leter me disa ceshtje per drejtimin e KOKSH.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të tij, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

**Auditues Ligjor**

**Ludmilla Paluka**



**Tiranë, më 20 Dhjetor 2021**